



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: Intesa Sanpaolo S.p.A./ Veneto Banca S.p.A.

Në datën 28 Korrik 2017, me shkresën Nr. 330 Prot., Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e thjeshtuar të përqendrimit në lidhje me një transaksion financiar që realizon shitjen dhe transferimin e disa asetëve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjeve Veneto Banca S.p.A, Banca Popolare di Venecia S.p.A tek Intesa Sanpaolo S.p.A.

Intesa Sanpaolo S.p.A është një shoqëri e regjistruar në Itali dhe është shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group, një nga grupet më të mëdhenj bankare italiane. Grupi është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet filialit në pronësi të plotë të tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA që operon me një rrjet prej 29 degësh dhe 3 agjencish të shpërndara në vend.

Transaksioni nuk përfshin ndonjë nga asetet e Banca Popolare di Venecia S.p.A në Shqipëri pasi kjo bankë nuk është prezente në Shqipëri, ndërkohë që përfshin të gjithë kapitalin e Veneto Banka Albania SHA, e cila është një filial në pronësi të plotë të Veneto Banca S.p.A.

Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit si dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi dhe Target janë prezent në Shqipëri dhe plotësohen kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- ✚ Blerësi: Intesa Sanpaolo S.p.A është një shoqëri e regjistruar në Itali, me adresë: Piazza San Carlo, Torino, Itali. Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group ("ISP Group"), një nga grupet më të mëdhenj bankare italiane. ISP Group është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet filialit në pronësi të plotë të tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA

- ✚ Shitësi/Targeti: Veneto Banca S.p.A. është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian, me seli në Piazza G.B. Dall'Armi 1, 31044 Montebelluna, Treviso Itali. Veneto Banca S.p.A është banka që drejton Veneto Banca Group, një nga institucionet italiane të kredisë të konsideruara si strategjikisht të rëndësishme nga Banka Qendrore Evropiane. Veneto Banca Group është i pranishëm në të gjithë Italinë dhe jo vetëm, ajo vepron gjithashtu edhe në disa vende të Evropës Lindore. Në Shqipëri ajo operon nëpërmjet filialit të saj Veneto Banka SHA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe neni 12, pika 1 dhe 2 , të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al